



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 52

Datë 16 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MTI nr. 1, datë 31.3.2014	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012 “Për dokumentet e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”, i ndryshuar	2061
Udhëzim i MZHUT nr. 2, datë 25.2.2014	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore, si dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e tyre....	2061
Udhëzim i MZHUT nr. 3, datë 17.3.2014	Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët për komunitetin rom.....	2064
Urdhër i MZHUT nr. 33, datë 25.2.2014	Për delegim kompetencash për procedurat e prokurimit publik....	2067
Urdhër i MZHUT nr. 56, datë 19.3.2014	Për delegim kompetence	2068

UDHËZIM

Nr. 1, datë 31.3.2014

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012 “PËR DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92 dhe 93 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 4 të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ndryshuar, neni 237 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1. Në nenin 3, pika 1, pas shkronjës “c”, shtohet pika “d” me këtë përmbajtje:
“d) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
2. Në nenin 3, pika 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
3. Në nenin 3, pika 3, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
4. Në nenin 3, pika 4, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
5. Në nenin 3, pika 4.1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
6. Në nenin 13, pika 1.1, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Kontratën e sigurimit të mjetit. Për këtë rast, nëse kontratat nuk janë të reja, fotokopje e kontratave ekzistuese”.
7. Në nenin 23, pika 1, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
8. Në nenin 23, pika 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
9. Në nenin 23, pika 3, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
10. Në nenin 23, pika 4, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”
11. Në nenin 23, pika 4.1, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) Kontratën e sigurimit të mjetit.”

12. Në nenin 26, pika 1.1, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Kontratën e sigurimit të mjetit. Për këtë rast, nëse kontrata nuk është e re, fotokopje e kontratës ekzistuese”.

13. Në nenin 29, pika 1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”

14. Në nenin 36, pika 1 pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Kontratën e sigurimit të mjetit.”

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

UDHËZIM

Nr. 2, datë 25.2.2014

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMORE, SI DHE NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E TYRE

Në mbështetje të neni 102 të Kushtetutës, të neneve 70/8 dhe 70/11 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 9.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), si dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e tyre.

2. Shqyrtimi i kërkesës së subjektit, që paraqitet në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), mbi aplikimin për marrje leje zhvillimore për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MZHUT-ja, bëhet nga Komisioni Teknik në MZHUT.

3. Komisioni Teknik merr në shqyrtim kërkesën vetëm pasi ka verifikuar se subjekti ka kryer pagesën për “tarifën e aplikimit” (e përcaktuar në përmbushje të kërkesës së gërmës “C”, seksioni 8, i formularit TIP 1 “Kërkesë për kryerje punimesh”, shtojca 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, “Fatura e pagesës për tarifën e aplikimit”).

4. Vlera e tarifës së aplikimit është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, pavarësisht nga lloji i strukturës për të cilën kërkohet leja zhvillimore, e cila paguhet për llogari të MZHUT-së.

5. Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore dhe përdorimin për struktura apo punime brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MZHUT-ja, ngrihet “Komisioni teknik” me përbërje si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| - Zëvendësministri | kryetar; |
| - Sekretari i Përgjithshëm | anëtar; |
| - Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Territorit | anëtar; |
| - Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Planifikimit të Turizmit | anëtar; |
| - Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Urbane dhe Strehimit | anëtar; |
| - Drejtor i Drejtorisë Juridike | anëtar; |
| - Përgjegjës Sektori i Planifikimit Rajonal dhe Vendor | anëtar; |
| - Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës | anëtar; |
| - Specialist në Sektorin e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve | anëtar; |
| - Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ndjekjes së Projekteve dhe Financimeve të Huaja | anëtar. |

6. Komisioni Teknik asistohet nga Sekretariati Teknik që përbëhet nga Drejtoria e Politikave të Planifikimit të Turizmit, Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Standardeve dhe Antikorrupsionit dhe Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit.

7. Përcaktimi i emrave në përbërje të “Komisionit Teknik” për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore në MZHUT dhe “Sekretariatit Teknik”, bëhet nëpërmjet urdhrat të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

8. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore në MZHUT mblidhet me kërkesë të kryetarit të Komisionit, sa herë që kërkohet shqyrtimi i praktikave për leje zhvillimore, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

9. Në njoftimin e dhënë nga kryetari për mbledhjen Komisionit jepet agjenda e mbledhjes, vendi, data dhe ora e zhvillimit.

10. Mbledhja e Komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë të Komisionit. Përrjashtimisht, në pamundësi të pranisë së shumicës së anëtarëve, si më sipër, dhe vetëm për shqyrtimin e kërkesave për çështje të formës, mbledhja mund të kryhet me praninë e jo më pak se 3 anëtarëve të Komisionit, së bashku me kryetarin.

11. Kryetari i Komisionit cakton një person në rolin e sekretarit të këtij Komisioni.

12. Kërkesa për leje zhvillimore i dërgohet menjëherë për shqyrtim Komisionit Teknik. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës, Komisioni Teknik kryen shqyrtimin e kërkesës për çështje të formës.

13. Kërkesa për leje zhvillimore duhet të përmbajë, sipas rastit:

a) Kërkesën për kryerje punimesh të plotësuar, në çdo pjesë të zbatueshme të saj, nga kërkuesi i lejes zhvillimore, sipas formularit TIP 1 të shtojcës 2 të vendimit të Këshillit Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011, të ndryshuar;

b) Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për subjektin kërkues të lejes dhe zbatuesin e punimeve, ku të pasqyrohet dhe fakti që nuk janë në gjendje likuidimi apo falimentimi;

c) Dokumentin që vërteton pronësinë mbi tokën që do të zhvillohet, sipas standardeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (certifikatë për vërtetimin e pronësisë, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese e regjistrimit) dhe vërtetim nga ZRPP-ja në lidhje me barrën apo kufizime të mundshme mbi pasurinë e paluajtshme ku propozohet të zhvillohet;

ç) Prokurën, përmes së cilës, pronari apo pronarët, sipas rastit, autorizojnë kërkuesin e lejes zhvillimore, në rast se leja nuk kërkohet nga pronarët;

d) Aktin noterial të lidhur midis zhvilluesit dhe shoqërisë/shoqërive zbatuese, si dhe licencat për punime zbatimi. Licenca e shoqërisë zbatuese shoqërohet edhe me vërtetim nga gjykata, prokuroria, përmbarimi dhe inspektorati ndërtimor;

dh) Pozicionin e zhvillimit në kuadër të planeve të miratuara për zonën përkatëse;

e) Planin e vendosjes së strukturës/strukturave, ku paraqiten kufijtë e pronave, gjurmët e rrugëve ekzistuese dhe ato të propozuara nga planet, distancat, tabela me llogaritjet e mënyrës së zbatimit të intensitetit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për ndërtesa, rrugë dhe hapësirë publike. Ky plan shoqërohet edhe me rilevimin topogjeodezik, të firmosur nga organi ose individi me licencë gjeodezike;

ë) Projektin e plotë arkitektonik për të gjitha nivelet e strukturës. Ky projekt përmban edhe relacionin shpjegues, ku përshkruhen edhe rifiniturat;

f) Planin e lidhjes së strukturës me infrastrukturën në zonë. Në këtë plan paraqiten edhe të gjitha infrastrukturën ekzistuese në zonë;

g) Projektin e sistemimeve të jashtme, me firmën origjinale të projektuesve, me kuota altimetrike, paraqitja e zonave të gjelbra, numri dhe lloji i drurëve që do të mbillen, si dhe projekti i sistemimit të ujërave të shiut dhe lidhja e tij me rrjetin kryesor;

gj) Studimet gjeologo-inxhinierike për ndërtimet me ose mbi 5 kate dhe të dhënat gjeologjike për ndërtimet nën 5 kate, hidro-gjeologjike dhe harta sizmologjike. Studimi mikrosizmik inxhiniero-sizmologjik kërkohet për ndërtimet me ose mbi 8 kate;

h) Planin e organizimit të punës dhe grafikun e punimeve e të mbikëqyrjes së punimeve, me firmën origjinale të projektuesve. Në planin e organizimit të punimeve përcaktohen qartë edhe: rrethimi i sipërfaqes së sheshit të kryerjes së punimeve, vendet e depozitimit të materialeve, vendi i tabelës informuese të ndërtimit, pozicioni i vinçit, depozitat e ujit për përdorim ndërtimi, skema e qarkullimit të mjeteve të transportit dhe mbrojtja e sigurimit teknik gjatë ndërtimit, në shkallën 1:500 dhe 1:200;

i) Projektin teknik të zbatimit dhe preventivin e realizimit të punimeve. Ky projekt, dorëzohet me firmë origjinale nga projektuesit, shoqërohet me tabelën e fletëve për secilin nga projektet përbërëse si më poshtë, dhe përmban:

- projektin konstruktiv dhe planin e piketimit të strukturave;

- projektin e plotë të ngrohjes dhe ventilimit;

- projektin elektrik dhe projektin për instalimet hidrosanitare;

- parashikimin për vendosjen e kutisë postare;

- paraqitjen e elementeve të projektit arkitektonik që lehtësojnë aksesin apo eliminojnë pengesat për përdorimin e strukturës nga personat me aftësi të kufizuara;

- tipat e ndarjeve funksionale të strukturës, sipas rastit, sipërfaqet për secilin tip dhe në total, sasinë e njësive të ndarjeve funksionale, planimetritë për secilin tip.

j) Projektin e mbrojtjes kundër zjarrit;

k) Vërtetimin e kryerjes së pagesës për taksat dhe tarifatat vendore për ndërtimin dhe/ose zhvillimin e tokës;

l) Vërtetimin dhe/ose certifikatat e kryerjes së të gjitha pagesave mbi detyrimet e kërkuesit të lejes zhvillimore;

m) Sipas rastit, dokumentin e miratuar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

n) Fotokopje e noterizuar e licencave të projektuesve, si: arkitekti, konstruktori, inxhinierët elektrikë, hidro etj., të vlefshme brenda afatit të projektimit dhe ndërtimit të strukturës;

nj) Sipas rastit dhe llojit të zonës ku do të kryhen punimet, vërtetime, leje ose dokumente të tjera, që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për sektorë apo punime të veçanta.

14. Në rast se dokumentacioni i kërkesës nuk është i plotë, subjekti njoftohet duke i lënë një afat 30-ditor për plotësimin e të metave dhe mangësive.

15. Në rast se dokumentacioni i kërkesës është i plotë, MZHUT-ja boton menjëherë kërkesën për leje në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe bashkërendon punën me bashkinë/komunën ku propozohet të kryhet zhvillimi, me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore dhe/apo operatorët e shërbimeve publike, sipas nenit 70/16 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, për t’u siguruar se kërkesa është në përputhje me zhvillimin e lejuar në zonën përkatëse.

16. Komisioni bën afishimin në portalin e MZHUT-së, të njoftimit për kërkesën për leje zhvillimore.

17. Mbledhja e Komisionit Teknik për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimore në MZHUT, bëhet jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e dosjes me të gjitha materialet dhe dokumentacionin përkatës që lidhen dhe janë në plotësim të kërkesës së paraqitur nga subjekti për marrjen e lejes, përfshirë edhe opinionet e institucioneve të tjera shtetërore ose, kur vlerësohet e nevojshme nga ekspertë të fushës. Komisioni shqyrton kërkesën dhe merr vendimin brenda 15 ditë pune.

18. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje komplekse zhvillimore për MZHUT-në bën trajtimin e çështjeve si më poshtë:

- Shqyrton kërkesat për dhënie leje zhvillimore për struktura turistike apo struktura të tjera brenda fushës së veprimtarisë shtetërore që mbulon MZHUT-ja, duke kryer:

- a) kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja teknike dhe ligjore të dokumentacionit që shoqëron aplikimin;

- b) vlerësimin e përputhshmërisë me instrumentet e planifikimit, mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia që mbulon fushën përkatëse në MZHUT.

- Mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e Komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë edhe opinionin nga institucionet e tjera ose ekspertë të fushës, Komisioni merr vendimin për:

- i) pranim të kërkesës;

- ii) refuzim të kërkesës, duke paraqitur te ministri informacionin me argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit.

19. Komisioni merr vendim me shumicë votash.

Për çdo kërkesë që shqyrtohet, Komisioni harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Në rast refuzimi të kërkesës, MZHUT-ja njofton subjektin aplikues duke dhënë edhe argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit. Subjekti aplikues ka të drejtën të aplikojë përsëri pasi të ketë plotësuar mangësitë e evidentuara.

20. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankimi te ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

21. Sekretariati i Komisionit Teknik përcjell në AKPT për procedim të mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) dosjen e kërkesës, e cila përfshin:

- propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit për shqyrtimin e kërkesës për leje;
- një kopje të vendimit të Komisionit Teknik në lidhje me kërkesën për leje;
- dokumentacionin shoqërues të kërkesës për leje.

22. Pas dërgimit në MZHUT të vendimit të KKT-së për miratimin e lejes zhvillimore, Sekretariati Teknik përgatit dokumentin administrativ teknik për zbardhjen e lejes, sipas formularit përkatës të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

23. Dokumenti administrativ teknik firmoset nga ministri i MZHUT-së në dy kopje origjinale.

24. Sekretariati i Komisionit Teknik, nëpërmjet zyrës së protokollit të MZHUT-së, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të firmosur të dokumentit administrativ teknik, që i referohet vendimit të KKT-së për miratimin e lejes zhvillimore, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së vendimit nga KKT-ja.

25. Leja e përdorimit, në përfundim të punimeve, jepet nga ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit pas vlerësimit nga Komisioni Teknik të dokumentacionit të depozituar si vijon: procesverbalit dhe aktit të kolaudimit, relacionit të mbikëqyrësit të punimeve, aktet e kontrollit të përpiluara nga specialistët e Komisionit Teknik, aktet e kolaudimit dhe/ose procesverbalet nga institucionet e rrjeteve të infrastrukturës.

26. Leja e përdorimit botohet në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

27. Në rast refuzimi të lejes së përdorimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili në pjesën e arsyetimit u referohet dokumenteve të akteve të kontrollit.

28. Sekretariati i Komisionit Teknik, nëpërmjet zyrës së protokollit në MZHUT, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit, të firmosur nga ministri.

29. Dosja e plotë e dokumentacionit të kërkesës për leje zhvillimore, së bashku me opinionet teknike, lejet përkatëse të zhvillimit dhe të përdorimit, depozitohet në arkivin e MZHUT-së.

30. Për ndjekjen e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i MZHUT-së, Komisioni Teknik dhe Sekretariati.

31. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, shpallet në portalin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

UDHËZIM
Nr. 3, datë 17.3.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT TË
PROGRAMIT TË BANESAVE ME KOSTO TË
ULËT PËR KOMUNITETIN ROM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 34/1, germa “c” të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom, ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

UDHËZON:

1. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat shprehin interesin e tyre për përfitimin nga programi i banesave me kosto të ulët për komunitetin rom, të paraqesin pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, kërkesën dhe projektet përkatëse të hartuara sipas termave të referencës që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

2. Fondi prej 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekësh, planifikuar në planin e investimeve të buxhetit të MZHUT-së për vitin buxhetor 2014, të jepet në formë granti për njësinë vendore, projekti i së cilës do të vlerësohet mes të gjitha projekteve të paraqitura.

3. Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij fondi do të jenë familje të komunitetit rom, të cilat pranojnë të angazhohen dhe aplikojnë pranë bashkive përkatëse në:

a) Projekte për përmirësimin e shërbimeve bazë, me vlerë jo më shumë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) Projekte të përmirësimit të banesave dhe/ose të pajisjes së truallit me infrastrukturë, me vlerë jo më shumë se 650,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

c) Projekte të banesave të reja me vlerë jo më shumë se 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

4. Organi i qeverisjes vendore është përgjegjës për miratimin e projektit, prokurimin dhe mbikëqyrjen e punimeve sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

5. Organi i qeverisjes vendore duhet të raportojë:

a) Brenda datës 5 të çdo muaji, mbi realizimin e financimit, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;

b) Brenda datës 5 të çdo fund tremujori, realizimin e financimit dhe ecurinë e realizimit të treguesve fizikë të projektit, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;

c) Brenda 10 ditëve nga përfundimi i punimeve dhe përpara kolaudimit të punimeve, te ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

6. Fondet e papërdorura nuk mbarten në vitin pasardhës. Ato mund të rialokohen deri në datën 15 qershor 2014, në projekte të tjera brenda programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**

TERMAT E REFERENCËS PËR PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

Shuma e financimit: _____ milion lekë;

Burimi i financimit: Buxheti i shtetit për vitin.....

Qëllimi i financimit: Investime për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian

Kush mund të marrë pjesë: Çdo institucion publik apo privat që ka projekte të gatshme sipas kushteve teknike të projektimit dhe kërkon financim, ose që synon të zbatojë një projekt për komunitetin rom dhe egjiptian. Çdo subjekt, si më sipër, duhet të aplikojë nëpërmjet njësisë vendore përkatëse.

1. HYRJE

Strategjia kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom dhe egjiptian”, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 18.9.2003, përfshin një sërë fushash prioritare, ndër të cilat strehimi, arsimit, punësimi, ulja e varfërisë, mbrojtja sociale, shëndetësia dhe infrastruktura.

Në kapitullin e strehimit, objektivat e Strategjisë synojnë të sigurojnë nevojat minimale për strehim, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të banesave apo sigurimit të banesave të reja.

2. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

a) Projekti realizohet në kuadër të politikave të strehimit, të cilat synojnë që, deri në vitin 2020, të kenë përmirësuar kushtet e banimit për rreth 80% të komunitetit rom dhe egjiptian, që banon në kushte të vështira dhe të papërshtatshme.

b) Objektivat e projektit janë:

- Të sigurojë kushte banimi të përmirësuara.

c) Gjatë realizimit të projektit të marrin pjesë si të punësuar nga komuniteti rom dhe egjiptian.

3. FUSHA E PËRDORIMIT TË FINANCIMIT

MZHUT-ja do të planifikojë fonde në zbatim të strategjisë në fjalë në buxhetin afatmesëm 2014-2017, bazuar në konkurrimin e projekteve të hartuara edhe të depozituara prej bashkive, komunave, qarqeve në kushtet e sotme dhe më pas në zbatim të ligjit të ri të territorit. Për vitin 2014 fondet e alokuara janë 30 mln lekë.

a) Përmirësimi i kushteve fizike të banesave;

- rikonstruksion i pjesshëm;

- rikonstruksion i plotë;

- përshtatja e ngrehinave të improvizuara për strehim.

b) Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës

- përmirësimi i sistemit të ujësjellësit;

- përmirësimi i kanalizimeve (KUZ + KUB);

- përmirësimi i sistemit rrugor;

- përmirësimi i furnizimit me energji elektrike.

c) Për raste të veçanta mund të paraqiten edhe projekte për ndërtim i banesave të reja, me kushtin që:

- projektet të jenë të thjeshta në projektim dhe zbatim;

- banesat të mos ngrihen në më shumë se dy kate;

- të mos kenë më shumë se 4 apartamente në një godinë;

- të mos ketë mjedise të përbashkëta (korridore, shkallë etj.);

- të mos jenë më të mëdha se 60 m² për secilën banesë;

- trualli të jetë pronë shtetërore;

- zona të jetë e pajisur me infrastrukturën bazë.

Projektet sipas pikës “c” zbatohen në vartësi të mundësive financiare për komunitetin rom dhe egjiptian.

Banesat sociale ngelen në pronësi të bashkive, por komuniteti rom dhe egjiptian duhet të paguajë qira sociale, e cila nuk duhet të jetë jo më e lartë se 25% e të ardhurave të tyre. Në rastin kur njësisia vendore ka parashikuar ndërtimin e banesave me kosto të ulët, kjo e fundit duhet të sigurohet që anëtarët e komunitetit, që do të përfitojnë banesat, të kenë të ardhura të mjaftueshme për të shlyer vlerën e investimit.

4. DOKUMENTACIONI QË DUHET PËRGATITUR NGA BASHKIA/KOMUNA

Bashkia ose komuna (OQV) duhet të paraqesë:

- Kërkesë me shkrim, e cila duhet të përmbajë:

- Përshkrimin e detajuar të gjendjes së banimit të komunitetit rom dhe egjiptian që synon të prekë projekti, numrin e familjeve, përbërja familjare, gjendjen sociale, nivelin e të ardhurave etj.;

- Përshkrimin e objektiveve të projektit;

- Përshkrimin e metodologjisë se si do të zbatohet projekti;

- Grafikon e realizimit të projektit dhe elemente të zbatimit të tij;

- Projektin e plotë dhe preventivin së bashku me specififikimet teknike;

- Financime të siguruara nga burime të tjera të specifikuar dhe të dokumentuara;

- Formularin e aplikimit, i cili gjendet bashkëlidhur.

Nga eksperiencia e deritanishme, rezulton se:

- Projektet e vogla janë më eficiente për t'u zbatuar brenda vitit dhe për të dhënë rezultate të shpejta;

- Projektet që synojnë ndërtime të reja duhen planifikuar si projekt më vete dhe të mos futen në skemën e granteve të vogla;

- Procedurat për miratimin e projekt-propozimeve duhet të fillojnë më parë (mundësisht para mbylljes së vitit korrent);

- T'i kushtohet vëmendje më e madhe monitorimit të projektit;

- Të përcaktohen që në fillim detyrimet e njësive vendore për realizimin e projektit;

- Aplikantët për këto fonde duhet të kenë kapacitetet administrative për të ndërmarrë projektin e propozuar.

5. KRITERET E VLERËSIMIT PËR PËRCAKTIMIN E FITUESIT

- Angazhimi i komunitetit rom dhe egjiptian në implementimin e këtij projekti (pra, punësimi i tyre).

- Kostoja për njësi (familje) për buxhetin e shtetit për projektet të mos jetë më e lartë se 650,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Në rast se këto kosto janë më të larta, ato duhet të mbulohen nga burime të tjera jashtë buxhetit të shtetit.

- Kostoja për njësi për buxhetin e shtetit për ndërtime të reja të mos jetë më e lartë se 1,200,000 lekë për familje. Në rast se kostot janë më të larta, ato duhet të financohen nga burime të tjera.

- Për kriteret e vlerësimit të projekteve të paraqitura në MZHUT, vlerësimi do të bëhet referuar si më poshtë:

Kriteri 1. Përmirësimi i kushteve fizike të banesave

Numri i familjeve të komunitetit rom ose egjiptian që përfitojnë nga projekti	Pikët
Deri në 40	0 - 10
41 - 50	11 - 30
50 - 70	31 - 60
70 - 90	61 - 80
Mbi 91	100

Kriteri 2. Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës

Numri i familjeve të komunitetit rom që përfitojnë nga projekti	Pikët
Deri në 40	0 - 10
41 - 50	11 - 30
50 - 70	31 - 60
70 - 90	61 - 80
Mbi 91	100

6. TREGUESIT E MONITORIMIT TË PROJEKTIT

- Treguesit fizikë të projektit

- Përmirësimi i banesave:

- përforsim themelit _____ m³;

- përforsim i muraturës mbajtëse _____ m³;

- rikonstruksion ose riparim çatie/tarrace _____ m²;

- shtesë dhome/banjoje/aneks gatimi _____ m²;

- F.V. dyer, dritare _____ m²;

- F.V. pajisje hidrosanitare _____ copë;

- instalime elektrike _____ lekë.

- Përmirësimi infrastrukturës

- lidhja e banesave me sistemin ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimeve _____ metër linear;

- vendosje e çezmave kolektive _____ numër;

- ndërtim pusi për marrjen e ujit _____ numër

- ndërtim grope septike;

- ndërtimi KUZ, ndërtimi i ujësjellësit dhe lidhja me rrjetin ekzistues;

- Ndërtim banesash të reja:

- numri i apartamenteve _____

- lloji i apartamentit dhe sipërfaqet mesatare të ndërtimit.

- [1+1] _____ numër _____ m²/apartament/banesë

- [2+1] _____ numër _____ m²/apartament/banesë

- [3+1] _____ numër _____ m²/apartament/banesë

- sipërfaqja totale e ndërtimit _____ m²

- Treguesit socialë

- numri i familjeve që do të përfitojnë _____

- numri i pjesëtareve të familjeve (nr. familje x nr. pjesëtarë /familje) _____

- të ardhurat mesatare mujore për çdo familje.

7. DISBURSIMI I FONDEVE

- buxheti i shtetit;

- donatorë.

8. PËRGJEGJËSITË E ZBATIMIT DHE MONITORIMIT

Njësia e qeverisjes vendore që përfiton financimin ka përgjegjësi për hartimin e projektit për kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore për prokurimin e fondeve publike, zbatimin e projektit dhe mbikëqyrjen e kolaudimin. Zbatimi i treguesve fizikë e socialë të projektit do të monitorohen nga MZHUT-ja.

Monitorimi do të kryhet në tri faza:

a) Faza e parë është ajo e njohjes me projektin dhe verifikimi në vend i terrenit në të cilin do të realizohet projekti;

b) Faza e dytë e monitorimit do të zhvillohet gjatë procesit të zbatimit të punimeve;

c) Faza e tretë do të zhvillohet brenda 10 ditëve nga njoftimi i mbylljes së punimeve.

FORMATI I APLIKIMIT

BASHKIA/KOMUNA _____

- Projekti për të cilin aplikohet (vendosni kryq në njërën apo disa kuti):

a)	Rikonstrukcion i pjesshëm	
b)	Rikonstrukcion i plotë	
c)	Përmirësimi i infrastrukturës	
d)	Ndërtim banesash të reja për komunitetin rom dhe egjiptian	

- Të dhëna për komunitetin rom dhe egjiptian që banon në bashkinë/komunën _____

1. Numri i familjeve;
 2. Përbërja familjare (persona për familje);
 3. Numri i fëmijëve për familje;
 4. Të ardhurat mesatare;
 5. Aktiviteti bazë nëpërmjet të cilit gjenerojnë të ardhura;
 6. Numri i personave të regjistruar në gjendjen civile;
 7. Numri i fëmijëve që ndjekin shkollën.
- Të dhëna për standardet ekzistuese të banimit
1. Numri i banesave;
 2. Lloji i banesës:

a) Banesë e ndërtuar me mure tulle/blloqe betoni (numër);

b) Banesë ose ngrehinë e improvizuar (numër);

c) Mjedis/objekt publikë (numër familjesh, lloji i objektit);

d) Tjetër _____

3. Lloji i pronësisë mbi banesën dhe truallin:

a) Në pronësi të familjes së regjistruar;

b) Në pronësi të familjes (e trashëguar) së paregjistruar;

c) Banesë e ndërtuar në mënyrë informale:

i) në proces legalizimi;

ii) jo në proces legalizimi;

iii) ndërtuar në tokë në pronësi të vetë;

iv) ndërtuar në tokë pronë private;

v) ndërtuar në tokë pronë shtet.

- Të dhëna për komunitetin që përfitojnë nga projekti:

a) Numri i familjeve që përfitojnë nga projekti;

b) Numri i përfituesve (nr. familje x përbërjen familjare);

c) Të ardhurat mesatare;

d) Kushtet e banimit (të bashkëlidhet raporti i gjendjes reale).

Kostot e projektit dhe burimet e financimit

Nr.	Bashkia/komuna	Lloji i projektit			
		Rikonstrukcion i pjesshëm	Rikonstrukcion i plotë	Punime në infrastrukturë	Ndërtim i ri
	1	2	3	4	5
a)	Kostoja totale e projektit				
b)	Fonde që kërkohen nga buxheti				
c)	Kontributi i bashkisë/komunës				
ç)	Kontribut nga donatorë të tjerë (specifikoni)				
d)	Kontribut tjetër				
dh)	Nr. i familjeve që përfitojnë				
e)	Kosto/njësi e projektit (a/dh)				
ë)	Kosto/njësi për buxhetin (b/dh)				
f)	Kriteri skualifikues (b/dh)				

URDHËR

Nr. 33, datë 25.2.2014

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit publik për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Robert Gjini.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datën 31.12.2014.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

URDHËR
Nr. 56, datë 19.3.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Turizmit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006